



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo
Ministry of lokal government Administration

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall:

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për promovimin e të të hyrave vetanake
Departamenti: Departamenti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal
Orari i punës: Orar i plotë i punës
Grada e Vendit të punës: 9
Koeficienti: 7
Raporton tek: Divizioni për Avansim të Buxheteve Komunale
Lloji i pozitës: I/E karrierës
Mbikëqyrja e stafit: 0
Referenca: MAPL/DBZHR 16-04-2014

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndihmojë komunat në planifikimin e buxhetit në bashkërendim me Ministrinë e Financa dhe të bëjë sigurimin e mjeteve të mjaftueshme buxhetore për administratën komunale me qëllim të ofrimit efikas dhe efektiv të shërbimeve;
2. Të ndihmojë komunat lidhur me promovimin e të hyrave vetanake për tua sqaruar qytetarëve ndryshimet si rezultat i reformave të politikave si të pushtetit qendror ashtu edhe atij lokal;
3. Të shqyrtojë vlerësimet buxhetore si dhe propozimet nëse të njëjtat janë të plota, të sakta dhe në përputhje me procedurat e vendosura, rregulloret si dhe me objektivat organizative;
4. Të jetë i kyçur në programin për vlerësimin e performancës, në analizën e politikave dhe legjislacionit që lidhet me buxhetin;
5. Të ndihmojë në përgatitjen e raporteve gjashtëmujore dhe atyre vjetore lidhur me realizimin e të hyrave vetanake të komunave si dhe t'i analizojë të këto raporte;
6. Të përgatitë diagrame të detajuara mbi buxhetin komunal / të hyrat vetanake, tabela dhe prezantime, me qëllim të mbështetjes së analizave të llojllojshme buxhetore;
7. Të ofrojë përkrahje për komunat lidhur me çështjet të cilat kanë të bëjnë me buxhetin/ të hyrat vetanake si dhe me zgjidhjen e problemeve të tilla si dhe të zbatojë politikat buxhetore;
8. Të kryejë edhe detyra të tjera me kërkesë të Udhëheqësit të Divizionit dhe të Udhëheqësit të Departamentit;

Kualifikimi dhe përvoja:

- Diplomë universiteti në fushën e ekonomisë dhe financave.
- Së paku 2 vite përvojë pune;
- T'i njohë gjuhët zyrtare;
- Të ketë aftësi për identifikimin e pavarur dhe analizën komplekse të kontabilitetit dhe të problemeve të ndërlikuara financiare, si dhe për bashkërendimin e duhur të zbatimit të zgjidhjeve;
- Të demonstrojë shkathtësi analitike të cilat i mundësojnë interpretimin e informatave të cilat lidhen me buxhetin dhe me financat;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara për planifikim dhe të jetë i aftë për realizimin e planeve;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme për komunikim si dhe aftësi të shkëlqyeshme ndër-personale;
- Të jetë i aftë për të punuar në mënyrë efektive me qëllim të përmbushjes së afateve të caktuara kohore;
- Të ketë shkathtësi shumë të mira kompjuterike (aplikacionet Microsoft, internet etj).

Aktet ligjore dhe aktet nën –ligjore që rregullojnë rekrutimin

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligjin Nr. 03/L -149 Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil .

Kohëzgjatja e emërimit

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit është në përputhje me LSHCK Nr. 03/L-149, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese njëvjeqare për pozitë.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Formularët zyrtar për aplikim merren në Zyrën e Personelit të MAPL-së, Kati XII -zyra 1203 , ndërtesa e ish-Rilindja, gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga ueb -Faqja e MAPL -së.

Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj..., mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MAPL-së dhe përmes postës.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar(postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Procedura e Konkurrimit

Procedura e konkurrimit është jashtë dhe te drejte aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në ueb-Faqen e Ministrisë:

mapl.rks-gov.net

Për informata shtesë mundë të kontaktoni Zyrën e Personelit të MAPL-së, në telefonin: **038-200 35-610**

